



ARGUMENTUM

news opinion analysis



100 Vjetori i Marrëdhënieve
Diplomatike Shqipëri-Rusi:

**“Ambasadori rus në Shqipëri,
Alexey Zaytsev flet për
të ardhmen, bashkëpunimin
ekonomik dhe paqen”**

- Donald Trump
zgjidhet presidenti
i 47-të i SHBA-së

- A ka Evropa zgjidhje për
dialogun Kosovë-Serbi?

- Trump, Xi dhe Putin:
një trekëndësh
jofunksional dashurie

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 FOKUS

- Donald Trump zgjidhet presidenti i 47-të i SHBA-së.
- Mbahet në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare në 75-vjetorin e marrëdhënies diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës.

07 POLITIKE

- Kuvendi Kombëtar i Gjuhës Shqipe, një diskutim mbi shqipen dhe sfidat e saj në shekullin e XXI.
- Nënshkruhet në Baku memorandum i gazifikimit, Balluku: Projekti nis nga Korça vitin e ardhshëm.

10 INTERVISTA

- 100 Vjetori i Marrëdhënies Diplomatike Shqipëri-Rusi: “Ambasadori A. Zaytsev flet për të ardhmen, bashkëpunimin ekonomik dhe paqen në kontekstin e zhvillimeve globale”

16 JO VETEM LAJM

- A ka Evropa zgjidhje për dialogun Kosovë-Serbi?
- Pse nuk kemi pasur lider të mëdhenj deri tani?

19 REALPOLITIK

- Trumpi tronditi politikën botërore! BE e re me sfida të vjetra! Komunitet ambulant! Xhiroboosh!

21 RAJON

- Fjalimi i fundvitit në Kuvend/ Presidentja Osmani: Rrezikimi i partneritetit me aleatët cenon vetë mbrojtjen e Kosovës.
- Ish-ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, emërohet zëvendëssekretare e Përgjithshme e NATO-s.

23 GLOBAL

- Trump, Xi dhe Putin: një trekëndësh jofunksional dashurie me aksione të një rëndësie globale

ENGLISH EDITION

26 ENGLISH TOP NEWS

- Baku, Azerbaijan – Prime Minister Edi Rama participates in the World Leaders’ Summit on Climate Action.

27 INTERVIEW

- A Century of Diplomatic Relations Between Albania and Russia: Exclusive Interview with the Russian Ambassador to Albania, H.E. Alexey Zaytsev.

29 REALPOLITIK

- Trump shook the world politics!
The new EU with old challenges! Ambulant Community! Empty diplomatic shuttle!

29 BALKAN OVERVIEW

- Mickoski-Kurti: Kosovo and North Macedonia Will Have Economic Cooperation Exceeding Half a Billion Euros.

DONALD TRUMP

zgjidhet presidenti i 47-të i SHBA-së



Ish-Presidenti Trump ka mundur zëvendëspresidenten Kamala Harris në një fitore mahnitëse, duke i dhënë atij një mandat të dytë në Shtëpinë e Bardhë – pas një cikli historik elektoral të mbushur me ngjarje të paprecedenta dhe dy tentativa për vrasjen e tij, sipas Fox News. Trump do të jetë presidenti i parë që do të shërbejë dy mandate jo të njëpasnjëshme – që nga koha e Grover Cleveland në 1892 – dhe vetëm i dyti në histori.

Trump u zgjodh për herë të parë president në vitin 2016, duke mposhtur ish-sekretaren e Shtëtit Hillary Clinton dhe duke u zotuar për ta “Bërë Amerikën përsëri të Madhe”.

Ai humbi rizgjedhjen ndaj rivalit presidentit Biden në vitin 2020 – gjatë pandemisë globale të koronavirusit, por rikërkoi Shtëpinë e Bardhë në 2024 pas një fushate gati 2-vjeçare, duke u zotuar për ta “Bërë Amerikën përsëri të Madhe”.

Trump njoftoi zyrtarisht fushatën e tij presidenciale më 15 nëntor 2022 – vetëm disa ditë pas zgjedhjeve afatmesme.

Trump bëri fushatë për një mandat të dytë dhe u fokusua në dështimet e administratës Biden-Harris.

Ish-presidenti ishte në gjendje të tregonte përmbysjen e disa prej politikave të tij kryesore – që lidheshin me arsyet pse inflacioni ishte rritur dhe pse kriza kufitare e SHBA-së ishte

përkeqësuar.

Trump mposhti lehtësisht kundërshtarët e tij – të cilët përfundimisht pranuan që ai të ishte presidenti i 47-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës – duke fituar çdo garë paraprake.

Pritshmëritë nga mandati i dytë i Presidentit Trump

Korrespondentja e Zërit të Amerikës, Tina Trinh, i hedh një vështrim politikave të kaluara të Presidentit Trump dhe qëndrimit aktual për të ofruar një pasqyrë se si mund të jetë presidenca katërvjeçare e republikanit Trump.

Ish Presidenti Donald Trump, 78-vjeçar, do të rikthehet në Shtëpinë e Bardhë për një mandat të dytë.

Ashtu si Presidenti Grover Cleveland në fund të viteve 1800, Presidenti Trump do të shërbejë dy mandate të shkëputura, si presidenti i 45 dhe 47 i Shteteve të Bashkuara.

Por si do të jetë mandati i dytë i Presidentit Trump, duke patur parasysh presidencën e kaluar dhe premtimet gjatë kësaj fushate. Emigracioni ka një përparësi të madhe për zotin Trump dhe politikën e tij kufizuese janë të lidhura me pikëpamjet e tij nacionaliste “Amerika e para”.

Shtatë ditë pasi mori presidencën në vitin 2017, zoti Trump vuri një kufizim 90 ditor, që ndaloi hyrjen në Shtetet e Bashkuara të shtetasve nga shtatë vende me shumicë myslimane.

“Po vendosim masa të reja verifikimi për të mbajtur jashtë Shteteve të Bashkuara terroristët islamikë radikalë. Nuk i duam këtu”.

Gjatë fushatës presidenciale të këtij viti, zoti Trump foli me forcë për atë që ai e quan “pushim nga emigrantët”, duke e bërë sigurinë kufitare një çështje kyçe elektorale. Gjatë një tubimi në Karolinën e Veriut ai u shpreh se



Gjatë fushatës presidenciale të këtij viti, zoti Trump foli me forcë për atë që ai e quan “pushim nga emigrantët”, duke e bërë sigurinë kufitare një çështje kyçe elektorale. Gjatë një tubimi në Karolinën e Veriut ai u shpreh se çfarë do t’i thoshte presidentes së re të Meksikës.

çfarë do t’i thoshte presidentes së re të Meksikës.

“Do ta informoj atë se nëse nuk e ndalon valën e kriminelëve dhe drogës që futet në vendin tonë, do të vendos menjëherë një tarifë 25% për gjithçka që dërgojnë në Shtetet e Bashkuara”, tha republikani Trump.

Gjatë kohës në Shtëpinë e Bardhë, Presidenti Trump vuri tarifa ndaj importeve kineze dhe

duket se nuk ka gjasa të ndryshojë taktikat.

“Ata na kanë dëmtuar, duke shkaktuar humbje të vendeve të punës dhe pastaj eksportojnë në Shtetet e Bashkuara prodhimet e tyre duke shmangur taksat. Kështu që ne humbasim. Humbasin kompanitë amerikane dhe mbyllen vendet e punës. Kështu bëhemi humbës të mëdhenj”, tha zoti Trump duke folur mbi tarifën ndaj Kinës.

Presidenti Trump e tërhoqi Uashingtonin nga Marrëveshja e Parisit e vitit 2015, një traktat ndërkombëtar që trajton ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale

“U zgjodha për të përfaqësuar qytetarët e Pitsburgut, jo të Parisit”.

Zoti Trump thotë se politika e tij energjetike do të përqendrohet tek rritja e nxjerrjes së naftës në vend dhe eliminimin e disa rregullave mjedisore.

“Ditën e parë, orën e parë, ne mund të bëjmë shumë gjëra, por fillimisht do të nxjerrim naftën në vend”, tha zoti Trump.

Në mandatin e tij të dytë si president, republikani Trump po premtonte një qasje më proteksioniste dhe izoluese sesa katër vitet e fundit të Presidentit Joe Biden.

Mbahet në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare në 75-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri organizuan më 11 nëntor një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare për të shënuar 75-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës.

Në këtë konferencë morën pjesë akademike, studiues dhe ekspertë nga institucione të njohura të dy vendeve, duke përfshirë, Studiues nga Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, dhe me pjesëmarrjen e studiuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të Shanghai Academy of Social Sciences – SAAS dhe të Beijing Foreign Studies University- BFSU.

Në konferencën shkencore ndërkombëtare për 75-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës,

shkëmbimi i dijes dhe eksperiencave midis studiuesve të fushave të ndryshme ishte në qendër të diskutimeve. Pjesëmarrësit e konferencës, ndanë njohuri dhe perspektiva të ndryshme mbi zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale gjatë këtyre 75 viteve.

Disa nga temat kryesore që u trajtuan ishin:

Historia dhe zhvillimi i marrëdhënieve diplomatike: Studiuesit analizuan periudhat kyçe dhe momentet që kanë shënuar avancimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës, duke përfshirë periudhat e bashkëpunimit më të ngushtë dhe sfidat që janë përballur gjatë dekadave të fundit.

Kultura dhe shkëmbimi ndërkulturor e njerezor: Studiuesit theksuan rëndësinë e shkëmbimeve kulturore dhe edukative për të thelluar mirëkuptimin reciprok mes dy popujve. Këto shkëm-

bime kanë pasur një ndikim të madh në forcimin e lidhjeve ndërmjet dy kombesh, duke nxitur një ndihmë të ndërsjellë në fusha si arti, letërsia, dhe turizmi.

Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ekonomik:

Një temë e rëndësishme që mori vëmendje ishte mundësia për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike, përfshirë mundësitë për investime, tregti dhe projekte të përbashkëta në fushën e infrastrukturës dhe teknologjisë.

Në konferencë, u theksua se bashkëpunimi dypalësh ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe ka pasur një ndikim të dukshëm në forcimin e lidhjeve politike, ekonomike dhe kulturore. Studiuesit theksuan se ky 75-vjetor është një mundësi e shkëlqyer për të konsoliduar më tej këto marrëdhënie dhe për të

zhvilluar projekte të reja në të ardhmen, duke sjellë përfitime të ndërsjella për të dy shtetet.

Ambasadorja e Kinës në Shqipëri përshëndeti të ftuarit në konferencën akademike të organizuar për të festuar 75-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Kinës dhe Shqipërisë. Ajo theksoi rëndësinë e këtij jubileu dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të zhvilluar dhe thelluar marrëdhëniet mes dy vendeve.

Gjatë këtyre 75 viteve, Shqipëria ka qenë një nga partnerët e parë që ka vendosur marrëdhënie diplomatike me Kinën, dhe kjo ka sjellë një miqësi të fortë midis dy popujve. Ambasadorja theksoi se gjatë vitit 2023, marrëdhëniet tregtare dhe shkëmbimet ndërmjet dy vendeve janë rritur, duke përfshirë heqjen e vizave për qytetarët e të dy vendeve dhe një memorandum për bashkëpunimin turistik.

Për të ardhmen, Ambasadorja nënvizoi disa pika kyçe:

Forcimi i besimit të ndërsjellë politik – Kina mbështet integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe do të vazhdojë të respektojë dhe mbështesë zhvillimin e Shqipërisë në përputhje



me rrugën e saj të zgjedhur. Zgjerimi i bashkëpunimit praktik – Kina është e gatshme të ndihmojë Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë bujqësinë, energjinë, turizmin dhe arsimin, si dhe të inkurajojë investimet kineze në Shqipëri. Shkëmbimet njerëzore dhe kulturore – Ambasada është e angazhuar të promovojë shkëmbimet kulturore dhe njerëzore,

si dhe të thellojë mirëkuptimin e ndërsjellë midis dy popujve. Në përfundim, Ambasadorja e Kina bëri thirrje për përpjekje të përbashkëta për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për të ndërtuar një të ardhme të ndritur për marrëdhëniet Kinë-Shqipëri.

Konferencë shkencore ndërkombëtare

Në 75-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës




Me pjesëmarrjen e studiuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të Shanghai Academy of Social Sciences - SAAS dhe të Beijing Foreign Studies University- BFSU

Kina mbështet integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe do të vazhdojë të respektojë dhe mbështesë zhvillimin e Shqipërisë në përputhje me rrugën e saj të zgjedhur. Kina është e gatshme të ndihmojë Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë bujqësinë, energjinë, turizmin dhe arsimin, si dhe të inkurajojë investimet kineze në Shqipëri.



Kuvendi Kombëtar i Gjuhës Shqipe, një diskutim mbi shqipen dhe sfidat e saj në shekullin e XXI

Në vigjilje të Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe, nisi sot punimet Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”, me pjesëmarrjen e gjerë të akademikëve gjuhëtarëve, pedagogëve e mësuesve të gjuhës shqipe nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia e Veriut.

Kryeministri Edi Rama deklaroi sot se, Dita e Alfabetit është festë e përmotshme e të gjithë shqiptarisë, e cila kremtohet edhe në Shqipëri.

Në fjalën e tij në Kuvendin Kombëtar për gjuhën shqipe, “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI” Rama u shpreh se, “ky Kuvend vjen edhe si një produkt i Samitit të tretë të Diasporës që u mbajt në Tiranë në nëntorin e vitit të shkuar, ku shqipja ishte një nga temat, se s’ka si të jetë ndryshe, kryesore dhe nga ku ne dolëm së bashku me të gjithë atë komunitet me disa përfundime dhe morëm disa angazhime.

Rama gjithashtu lidhi këtë Kuvend me kujtimin e politikanit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Arben Xhaferrit.

“Për më tepër shtoi Rama, ma ha mendja se është ky vendi për të lidhur këtë Kuvend me kujtimin e Arben Xhaferrit, i cili sot nuk jeton më, por ishte shqiptari që pati idenë që të kërkojë që Dita e Alfabetit 22 nëntori të jetë festë kombëtare për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe që prej nga ky vit është edhe festë e përmotshme e të gjithë shqiptarisë, e cila kremtohet edhe në



Shqipëri”, tha Rama.

Rama shtoi se Dita e Kongresit të Manastirit është pjesë e zinxhirit të Besëlidhjeve të shqiptarëve “Në zinxhirin e historisë sonë ka pasur disa Besëlidhje, pa diskutim i madh dhe i vogël me njëherë Besëlidhje e lidhin me Kuvendin e Lezhës, pastaj, kush është pak më shumë i interesuar për historinë e lidh me Lidhjen e Prizrenit, por unë besoj se padyshim pjesë e zinxhirit të Besëlidhjeve të shqiptarëve është edhe Dita e Kongresit të Manastirit. Dita e një Kongresi ku një grup shqiptarësh patën vizionin, patën guximin dhe patën vullnetin t’u japin shqiptarëve atëherë dhe përgjithmonë Alfabetin e tyre, në kushte në të cilat kjo nuk ishte aspak diçka e lehtë apo e diçka që do të ndodhte medoemos”, tha Rama.

“Kongresi ku At Gjergj Fishta, më katoliku i katolikëve, tha “Uluni ju burra, uluni këtu në shesh të zgjedhim një komision që të

caktojë se ç’ka duhet të bajmë sot për të mirën e popullit shqiptar nesër”. Aty ku ku ortodoksi i ortodoksëve, Petro Nini Luarasi tha në kontekstin e alfabetit helen, “Ju lutem vëllezërve tanë, bashkombasve tanë myslimanë dhe katolikë, të mos vuajnë keq kur të shohin një pjesë e trupit shqiptar po vuan dhe po humbet dhe për qejf të klerit”. Ku Mit’hat Frashëri, arkitekti i Kongresit paraqiti vizionin e më myslimanit të myslimanëve, Hoxhës Hasan Tahsin për një alfabet të gjuhës shqipe, jo një alfabet arab, as një alfabet helen dhe aq më pak cirilik dhe të gjitha këto ishin opsione kërcënuese që peshonin mbi supet e pjesëmarrësve në atë Kongres”, tha Rama. “Historia ka folur dhe historia ka treguar sesa e guximshme ishte vendimmarrja e atij Kongresi, për një alfabet të veçantë në gjendje për të shprehur bashkë me fjalët e veçanta dhe shpirtin dhe botëkuptimin unik të shqiptarit”, tha Rama.

Nënshkruhet në Baku memorandumi i gazifikimit, Balluku: Projekti nis nga Korça vitin e ardhshëm



Kryeministri Edi Rama dhe zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku u takuan sot me Presidentin e Azerbajxhanit, Ilham Aliyev. Pas takimit, palët nënshkruan edhe memorandumin e bashkëpunimit mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Albgazit dhe kompanisë shtetërore të naftës në Azerbajxhan, SOCAR, për zhvillimin e infrastrukturës së gazifikimit të qytetit të Korçës. Në një deklaratë nga Baku pas nënshkrimit të marrëveshjes, Balluku u shpreh se kjo marrëveshje synon gazifikimin e vendit që do të nisë nga qyteti i Korçës në vitin 2025.

“Këtu në Baku gjatë zhvillimeve të COP 29 ne patëm edhe një marrëveshje të re me qeverinë e Azerbajxhanit, për sa i përket gazifikimit të Korçës. Është një lajm shumë i mirë ky, i cili ka nisur dhe është ngjizur prej kohësh midis Albgazi-t të Shqipërisë dhe Socar-it të Azerbajxhanit, por

tashmë po bëhet realitet”, tha Balluku.

“Planet tona janë që të nisim sa më parë nga puna duke nisur kështu me të gjithë pjesën inxhinierike tashmë që studimi i fizibilitetit ka

mbaruar. Parashikohet që ky projekt të nisë gjatë vitit 2025 për t’u dorëzuar në vitin 2027”, theksoi zëvendëskryeministrja.

Balluku u shpreh se, “ajo që synohet është që të mbulojmë një rrjet të tërë shpërndarjeje gjatë gjithë qytetit të Korçës, por nga ana tjetër kryesisht edhe në bizneset të cilat operojnë në këtë qytet”.

“Duhet pasur parasysh se sa më shumë do të shtrihet gazifikimi i Shqipërisë, bazuar në planin strategjik për gazifikimin e vendit, aq më shumë do të ulen kostot për sa i përket këtij produkti që do t’i jepet qytetarëve”, tha Balluku. Balluku sqaroi se gazifikimi më pas do të shtrihet edhe në zonën e Pogradecit dhe në zonën e Ersekës.

“Në fillim shteti do të nisë sigurisht duke e mbështetur këtë procedurë të re, këtë produkt të ri dhe shërbim të ri për më pas duke e zgjeruar këtë edhe në zonën e Pogradecit dhe në zonën e Ersekës dhe duke pasur parasysh që ne synojmë që industria të ketë

”**“Në fillim shteti do të nisë sigurisht duke e mbështetur këtë procedurë të re, këtë produkt të ri dhe shërbim të ri për më pas duke e zgjeruar këtë edhe në zonën e Pogradecit dhe në zonën e Ersekës dhe duke pasur parasysh që ne synojmë që industria të ketë alternativën e zgjedhjes të energjisë, pra jo vetëm përdorimin e energjisë elektrike, por edhe të gazit, ne parashikojmë që ky gazifikim i vendit të vazhdojë deri në vitin 2030.**”

alternativën e zgjedhjes të energjisë, pra jo vetëm përdorimin e energjisë elektrike, por edhe të gazit, ne parashikojmë që ky gazifikim i vendit të vazhdojë deri në vitin 2030, duke mbuluar pjesën më të madhe të qyteteve, të cilat kanë edhe pjesë industriale apo biznese, të cilat mbështeten nga industria e gazit”, tha ajo.

Ndërsa kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe njëherësh drejtues politik i PS në Korçë, Niko Peleshi, u shpreh se, “pa dyshim që është një lajm i shkëlqyer për Korçën dhe për rajonin dhe për gjithë Shqipërinë”.

“Korça është fatlume pasi gazsjellësi TAP kalon nga Korça, po jo vetëm kjo, edhe fakti që korçarët janë pagues të mirë të faturave të ujit, të kanalizimeve dhe të gjithë tarifave të tjerave, kjo besoj e bëri edhe Korçën qytet atraktiv për këtë projekt nga ku po fillon gazifikimi i Shqipërisë në fakt”, tha ai. “Lajm shumë i mirë për familjarët, për bizneset aktuale, për bujtinat, restaurantet, hotelet dhe bizneset e tjera ekzistuese, por lajm i mirë dhe për bizneset e reja, të cilat kur mendojnë se ku ta vendosin biznesin e tyre mund të ketë më shumë shanse të vendosin të zgjedhin Korçën ku kemi një burim energjie, më të lirë, alternativ. Pra në terma të interesave individuale, duke parë edhe si korçar kjo është një ulje e kostove për ngrohje, por dhe për gatim dhe një cilësi më e mirë jete sepse tani ne për fat të keq ne ende kemi shumë shtëpi që nuk arrijnë dot të ngrohin të gjithë ambientet dhe e përkthyer në terma të tjerë kjo është një jetë më e shëndetshme, sepse me gazin, me shpërndarjen e gazit në çdo familje do të kemi mundësi që të realizojmë një ngrohje me burim alternativ më të lirë të të



Lajm shumë i mirë për familjarët, për bizneset aktuale, për bujtinat, restaurantet, hotelet dhe bizneset e tjera ekzistuese, por lajm i mirë dhe për bizneset e reja, të cilat kur mendojnë se ku ta vendosin biznesin e tyre mund të ketë më shumë shanse të vendosin të zgjedhin Korçën ku kemi një burim energjie, më të lirë, alternativ.

gjithë ambienteve”, tha Peleshi. Balluku shtoi se, Shqipëria është angazhuar për mbrojtjen e mjedisit dhe mos përdorimin e lëndëve drusore për ngrohje.

“Ne na është dashur së bashku të merremi dy vite konsektiv për sa i përket lëndës drusore, e cila është tashmë gjithmonë e më pak e disponueshme, duke pasur parasysh këtu edhe eksportet nga Maqedonia e Veriut apo nga Kosova, pasi lënda drusore përdoret shumë në zonën e Korçës, por duke qenë se ne ndodhemi sot në COP 29 duhet të kemi parasysh që e gjithë politika për mbrojtjen e mjedisit dhe gjithë angazhimet që Shqipëria ka marrë për mbrojtjen e mjedisit shkon në të njëjtën udhë me mos përdorimin e lëndëve drusore për ngrohjen”, tha Balluku.

Nga ana tjetër, Balluku u shpreh se, Korça është zgjedhur për të pilotuar këtë projekt pikërisht sepse korçarët kanë treguar që janë qytetarë të mirë sa i përket të gjithë përballimit të faturave të shërbimeve.

“Korça është zgjedhur për të pilotuar këtë projekt, pra Strategjinë Kombëtare të Gazifikimit të vendit që mbështetet nga Socar, nga kompania e ekselencës së Azerbajxhanit sa i përket gazit në nivel ndërkombëtar, pikërisht sepse korçarët kanë treguar që janë qytetarë të mirë sa i përket të gjithë përballimit të faturave të shërbimeve duke mos krijuar asnjëherë debitë të këqija për asnjë nga kompanitë, qofshin këto UKT apo kompanitë elektrike”, tha Balluku.



“Shpesh dëgjojmë se si “ekspertët” dhe “vëzhguesit politikë” akuzojnë pa arsye Rusinë se kërkon, gjoja, të hapë një “front të dytë” në Ballkan, të destabilizojë situatën këtu për të larguar vëmendjen e vendeve të NATO-s nga konflikti ukrainas. Kjo nuk është e vërtetë. Rusia gjithmonë ka dalë në favor të ruajtjes së paqes në rajon.

100 VJETORI I
MARRËDHËNIEVE
DIPLOMATIKE SHQIPËRI-RUSI

“Ambasadori A. Zaytsev flet për të ardhmen, bashkëpunimin ekonomik dhe paqen në kontekstin e zhvillimeve globale”

Intervistë Ekskluzive për “Argumentum.al” me Ambasadorin e Federatës Ruse në Republikën e Shqipërisë, SHTZ. Alexey Zaytsev

Intervistoi: **Marjana Doda**
Kryeredaktore

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Rosisë.

Në një intervistë ekskluzive për **Argumentum.al**, Ambasadori i Federatës Ruse në Tiranë, i cili pak kohë më parë dorëzoi kredencialet e tij Presidentit të Shqipërisë, flet për historinë e marrëdhënieve diplomatike gjatë këtyre 100 viteve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik në të kaluarën, dhe mes Shqipërisë dhe Rosisë pas vitit 1990. Përveç kësaj, në kontekstin e rre-

thanave gjeopolitike globale, dhe konkretisht sa i përket luftës së Rosisë kundër Ukrainës, e cila ka hyrë tashmë në vitin e saj të tretë, Ambasadori tregon faktorët që çuan në këtë konflikt dhe mundësitë që ai të marrë një zgjidhje paqësore.

Përgjatë një shekulli, marrëdhëniet ndërmjet Rosisë dhe Shqipërisë kanë njohur periudha ngritjeje dhe rënieje, duke kaluar nëpër momente të vështira, por edhe faza bashkëpunimi të ngushtë, sidomos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Siç e thekson Ambasadori, marrëdhëniet zyrtare midis dy vendeve filluan në vitin 1924, me një iniciativë të qeverisë shqiptare për të kërkuar mbështetje nga Bashkimi Sovjetik, pas të cilës,

përfaqësuesi i parë diplomatik sovjetik mbërriti në Tiranë. Pavarësisht disa vështirësive politike të brendshme dhe ndërhyrjes së fuqive perëndimore, marrëdhëniet u rinovuan në vitin 1934 dhe vazhduan deri në ndërprerjen e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore.

“Marrëdhëniet ruso-shqiptare kanë njohur periudha luhatjeje, ku bashkëpunimi i ngushtë dhe ndihma sovjetike ishin më të shquara në mes të shekullit të 20-të, ndërsa tani ato janë në një nivel minimal, për shkak të orientimit të Shqipërisë në politikën perëndimore”, shprehet Ambasadori.

I pyetur për ndikimin e mundshëm të konfliktit ruso-ukrainas në sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe botë por dhe për mar-

rëdhëniet e ngushta mes Rusisë dhe Serbisë që shihen pengesë për paqen mes Serbisë dhe Kosovës, Z. Zaytsev thekson se kërcënim i ndikimit të krizës ukrainase në sigurinë globale nuk është potencial, por mjaft real. Ndërsa sa u përket çështjeve të sigurisë dhe stabilitetit në rajon, ai përgjigjet si vijon:

“Shpesh dëgjojmë se si “ekspertët” dhe “vëzhguesit politikë” akuzojnë pa arsye Rusinë se kërkon, gjoja, të hapë një “front të dytë” në Ballkan, të destabilizojë situatën këtu për të larguar vëmendjen e vendeve të NATO-s nga konflikti ukrainas. Kjo nuk është e vërtetë. Rusia gjithmonë ka dalë në favor të ruajtjes së paqes në rajon. Mungesa e përparimit në normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës kushtëzohet jo nga roli destruktiv i Kremlinit, por nga veçoritë historike dhe etno-fetare të çështjes së Kosovës, si dhe nga politika e SHBA-së dhe BE-së, të cilat për shumë vite janë përpjekur të monopolizojnë zgjidhjen, për ta çuar atë përtej bazës së vetme legjitime – rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke e detyruar Serbinë të njohë pavarësinë e Kosovës dhe t’i ndërpresë lidhjet vëllazërore historike midis popujve rusë dhe serbë. Fatkeqësisht, udhëheqësit evropianë harrojnë se zgjidhjet e imponuara, pa marrë parasysh interesat themelore të popujve që jetojnë në rajon, janë jetëshkurtra”.

Në lidhje me bisedimet për paqe dhe negociatat diplomatike, se pse deshtuan para nisjes së luftës dhe, gjithashtu, pse ato dështojnë edhe tani për të gjetur një zgjidhje përfundimtare të këtij konflikti, Ambasadori përgjigjet duke shpjeguar në mënyrë kronologjike të gjitha përpjekjet dhe angazhimet për bisedime dhe zgjidhje



Më 16 dhjetor 2024, në territorin e Ambasadës së Rusisë në Shqipëri u vendos një tabelë përkujtimore me rastin e 100-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike ruso-shqiptare. Në këtë ditë, në vitin 1924, një grup diplomatësh sovjetikë të kryesuar nga Përfaqësuesi Fuqplotë i BRSS në Shqipëri Arkady Antonovich Krakovetsky mbërritën për herë të parë në Tiranë.

paqësore të këtij konflikti. Duke theksuar se Rusia është e hapur për negociata dhe çdo propozim serioz që vërtet synojnë arritjen e paqes por jo ultimatumet si “Formula e Zelensky-t” ose iniciativa të tjera të ngjashme.

“Rusia ka propozuar në mënyrë të përsëritur, dhe kjo është e njohur për të gjithë, për të kërkuar një zgjidhje të problemeve në Ukrainë me mjete paqësore. Një plan realist për rivendosjen e paqes dhe integritetit territorial të Ukrainës u fiksua në “Kompleksin e masave për përmbushjen e Marrëveshjeve të Minskut” të nënshkruar në shkurt 2015, asnjë nga pikat e të cilit, meqë ra fjala, nuk u përmbush nga pala ukrainase. Në fund të vitit 2021 Kievi ka deklaruar haptazi për refuzimin nga marrëveshjet e Minskut dhe ka filluar të zbatojë një skenar të “kthimit” të Donbasit në Ukrainë me forcë. Diplomacia ruse nuk u step. Në dhjetor 2021, NATO-ja dhe SHBA-ja u ftuan të nënshkru-

anin me Rusinë dy marrëveshje për garancitë ligjore të sigurisë që do të hapnin rrugën për paqe të qëndrueshme në kontinentin tonë. Sidoqoftë, siç e dini, propozimet e Moskës u refuzuan.

Për më tepër, në tetor 2022 Presidenti i Ukrainës ka nënshkruar një dekret që e ndaloi atë të zhvillojë ndonjë negociatë me Rusinë. Ky dekret është ende në fuqi. Me pak fjalë, është regjimi i Kievit dhe sponsorët e tij përëndimorë që nuk kanë interes për një zgjidhje politike dhe diplomatike të krizës. Ndryshe nga Ukraina, Rusia është e hapur për negociata dhe çdo propozim serioz që vërtet synojnë arritjen e paqes. Sidoqoftë, këto duhet të jenë negociata, dhe jo ultimatumet si “Formula e Zelensky-t” ose iniciativa të tjera të ngjashme.

Në prag të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, ambasadori i Rusisë në Tiranë vlerësoi kontributin e Shqipërisë në këtë luftë të rëndësishme. Ai theksoi se më 29 nëntor të këtij viti, Shqipëria do të festojë 80 vjetorin e çlirimit nga forcat nazifashiste, një ngjarje që shënon një moment të madh në historinë e vendit. Ambasadori theksoi me krenari se populli shqiptar e arriti çlirimin me forcat e veta, duke paguar një çmim të lartë – me 28 mijë patriotë shqiptarë që dhanë jetën për lirinë e vendit. Ky akt i lavdishëm nuk do të harrohet kurrë, shprehet ai.

Në këtë intervistë, ndërsa rishikojmë marrëdhëniet e dy vendeve, duke u fokusuar jo vetëm në aspektet historike të së shkuarës, por edhe në mundësitë dhe perspektivat për të ardhmen, ambasadori shfaq një qëndrim optimist për zhvillimet e mundshme të marrëdhënieve dypalëshe duke

theksuar se duhet të shikojmë gjithmonë në të ardhmen me shpresë.

Ai thekson se ka shumë arsye për këtë optimizëm, duke përmendur se popujt e dy vendeve janë të lidhur nga një respekt i thellë për historinë dhe kujtesën e paraardhësve, dhe se kanë jetuar dhe bashkëjetuar në paqe për shumë shekuj, përfshirë komunitetet ortodokse, katolike dhe myslimane. Ambasadori thekson gjithashtu dashurinë e shqiptarëve për kulturën dhe artet ruse.

Nga ana tjetër, ambasadori nënvizon edhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën ekonomike, duke përmendur kompetencat e Rusisë në teknologji të lartë, digjitalizim, industrinë e mjekësisë dhe IT, si dhe burimet alternative të energjisë. *“Rusia është e gatshme të rinovojë bashkëpunimin ekonomik me Shqipërinë, sa herë që realitetet politike do ta lejojnë këtë”*, thekson ndër të tjera në këtë intervistë Ambasadori i Federates Ruse në Shqipëri **A.A.Zaitsev**

INTERVISTA E PLOTË:

Znj. Marjana Doda: Z. Ambasador, së pari Ju falënderoj për mundësinë e intervistës në kontekstin e 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ruso-shqiptare që shënohen këtë vit. Ky jubile na gjen në një periudhë të vështirë, të mbushur me sfida ndërkombëtare dhe paqëndrueshmëri në rritje në botë. Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet midis vendeve tona kanë një të kaluar të pasur, duke përfshirë bashkëpunimin politik, tregtar, ekonomik, kulturor dhe humanitar. Ndaj le të flasim për zhvillimin dhe perspektivat e marrëdhënieve ruso-shqiptare në të ardhmen.

– Si janë zhvilluar marrëdhëniet midis Rusisë dhe Shqipërisë që nga themelimi i tyre zyrtar?

SHTZ. Alexey Zaytsev: Në të vërtetë, ky vit ka mbushur 100 vjet të marrëdhënieve diplomatike ruso-shqiptare. Për herë të parë, çështja e themelimit të tyre lindi në qershor 1924, kur qeveria e F.Nolit, në përpjekje për të gjetur mbështetje ndërkombëtare, iu drejtua BRSS me një iniciativë të tillë. Në shtator të të njëjtit vit, pala sovjetike ra dakord dhe më 16 dhjetor 1924, pasi morën në Vjenë vizat hyrëse, një grup diplomatësh, i udhëhequr nga Përfaqësuesi Fuqiplotë sovjetik, A.A.Krakovecki mbërriti në Tiranë. Megjithatë, në kushtet e një situatë mjaft të ndërlikuar të brendshme politike në Shqipëri dhe të presionit të fortë politik ndaj qeverisë së F.Nolit nga ana e fuqive perëndimore, të cilat kundërshtonin vendosjen e lidhjeve midis Shqipërisë e Rusisë Sovjetike dhe praninë e misionit diplomatik sovjetik në Tiranë, qeveria e F.Nolit u shpreh për shtyrjen për pak kohë të vendosjes së përfaqësisë diplomatike sovjetike në kryeqytetin shqiptar. Tre ditë pas mbërritjes në Tiranë, Përfaqësuesi Fuqiplotë sovjetik, A.A.Krakovecki u detyrua të largohet nga vendi, ndërsa marrëdhëniet diplomatike midis BRSS dhe Shqipërisë u ngrinë deri në 1934. Me sugjerimin e mbretit të Shqipërisë, A.Zogu, ato u restauruan në vitin 1934. Pastaj u ndërpre në përsëri – tashmë deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore.

Siç mund ta shihni, në vitet e kaluara marrëdhëniet tona kanë përjetuar jo një herë ulje-ngritje. Kulmi i tyre ndodhi në vitet 1945-1961, kur BRSS dhe Shqipëria bashkëpunuan në

mënyrë aktive në fushat politike, tregtare, ekonomike, kulturore dhe humanitare. Bashkimi Sovjetik ndihmoi republikën e re për të krijuar bazën e industrisë. Me kërkesë të qeverisë shqiptare, në vend u dërguan specialistë sovjetikë, të cilët gjatë periudhës së përmendur kryen punë gjeologjike, trajnimin e punëtorëve të profesioneve masive, ndërtimin dhe montimin e ndërmarrjeve të mëdha industriale, disa prej të cilave ende funksionojnë. Në periudhën 1947-1957, BRSS i dha Shqipërisë kredi preferencialë në shumën prej më shumë se 500 milion rubla, nga të cilat 85% (422 milion rubla) me kërkesë të palës shqiptare u falën më pas nga qeveria sovjetike. Si rezultat, 25 uzina të ndërtuara me kredi nga BRSS në fakt iu dhuruan popullit shqiptar. Do të vërej se këto ndërmarrje siguruan 25% të të gjitha të ardhurave të marra nga sektori industrial i ekonomisë.

Në ato vite, shumë studentë shqiptarë përfunduan me sukses studimet në universitetet sovjetike. Ndër ta ishin shkrimtarët e shquar shqiptarë I.Kadare, D.Xhuvani, poeti dhe romancieri D.Agolli, figura të tjera të ardhshme të kulturës shqiptare, si dhe inxhinierë e teknikë.

Në vitet 1940-1960, në Shqipëri jetonin dhe punonin qytetarë të vendit tonë, të cilët dhanë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e shkencës dhe kulturës shqiptare. Midis tyre është Viktoria Puzanova, e cila u bë pioniere në studimin e artit mesjetar shqiptar. Ajo zbuloi emrin e piktorit të shquar të ikonave shqiptare Onufri, krijoi 32 kopje të afreskeve të vjetra kishtarë, të cilat edhe sot ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë dhe përbëjnë “fodin e artë” të tij. Burri i saj Vasily Puzanov, një or-

nitolog dhe taksidermist, dha një kontribut të paçmuar në zhvillimin e shkencave natyrore këtu, duke themeluar Muzeun e shkencave natyrore në Tiranë.

Duhet pranuar se gjendja aktuale e marrëdhënieve ruso-shqiptare është në kontrast me atë që u vu re në vitet 1945-1961. Sot, kontaktet zyrtare janë në nivelin minimal. Dhe arsyeja për këtë është kursi i Tiranës zyrtare, e cila në politikën e saj të jashtme solidarizohet plotësisht me qëndrimet e NATO-s, SHBA-së dhe BE-së, duke mbështetur çdo iniciativë antiruse.

- Si ndikon konflikti i Ukrainës në marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Rusisë, duke marrë parasysh se Tirana mbështeti sanksionet perëndimore kundër Rusisë, ndërsa Moska e përfshiu Shqipërinë në listën e vendeve jo miqësore?

-Siç tashmë e përmenda, Shqipëria i përmbahet me vendosmëri parimeve euroatlantike në arenën ndërkombëtare, duke iu bashkuar të gjitha formateve antiruse dhe sanksioneve të vendosura kundër vendit tonë nga Brukseli dhe Uashingtoni. Tirana zyrtare mbështet “formulën e paqes” të pathemeltë të Zelensky dhe merr pjesë në “Platformën e Krimesë”. Në të njëjtën linjë ishte samiti “Ukrainë-Evropë Juglindore” i mbajtur në Tiranë në shkurt të këtij viti, tema qendrore e të cilit ishte ofrimi i ndihmës gjithëpërfshirëse për regjimin e Kievit për t’i shkaktuar Rusisë një “humbje strategjike në fushën e betejës”. Pala shqiptare shfaq iniciativën e saj në çështjen e kundërshtimit të “kërcënimit rus” në organizatat ndërkombëtare. Kështu, në kuadër të Këshillit të Evropës, delegatët nga Shqipëria janë të përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin e

“regjistrin të dëmeve në Ukrainë”, në bazë të të cilit është planifikuar të formohet një lloj “mekanizmi kompensimi” për konfiskimin dhe transferimin e aseteve të ngri- ra ruse regjimit të Kievit. Jemi të bindur se krijimi dhe promovimi i mekanizmave të tillë nuk ka asnjë lidhje me një zgjidhje paqësore dhe ka për qëllim ndëshkimin e atyre që janë të përkundërt dhe frikësimin për të ardhmen të atyre që nuk pajtohen. Gjithashtu, kemi fiksuar faktin që autoritetet shqiptare nuk kanë shprehur ende asnjë fjalë dënimi për ndalimin në Ukrainë të Kishës Ortodokse kanonike Ukrainase. Theksoj: një vendim i tillë i autoriteteve të Kievit u mor në kundërshtim me të gjitha dokumentet e njohura ligjore ndërkombëtare në fushën e lirisë së besimit.

Thirrjet e palës ruse për të marrë një pozicion më të ekuilibruar dhe për t’u përmbajtur nga pjesëmarrja në formate hapur rusofobike, fatkeqësisht, injorohen nga autoritetet shqiptare. Një shembull i radhës është konferenca ministrore mbi aspektet humanitare të formulës së Zelensky e mbajtur në Otava (Kanada) më 30-31 tetor të këtij viti, në të cilën, ndër të tjera, u diskutua në detaje çështja e kthimit të fëmijëve ukrainas, gjoja, të “deportuar” nga autoritetet ruse në subjektet e Federatës Ruse. Pala ruse i bëri thirrje Shqipërisë të përmbahet nga pjesëmarrja në këtë projekt absolutisht propagandistik, i cili nuk ka asnjë lidhje me temën e një zgjidhjeje paqësore. Argumentet tona nuk u dëgjuan përsëri.

Theksoj: Rusia nuk ishte iniciatore e ftohjes së marrëdhënieve me Shqipërinë. Ky nuk është vendimi ynë. Moska është e hapur për bashkëpunim pragmatik me të gjitha vendet që janë të gatshme

të marrin parasysh interesat ruse. Do të vërej se ne gjithmonë nisemi nga marrëdhëniet e barazisë, nuk përpiqemi të imponojmë vullnetin tonë dhe nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të shteteve sovraane. Krahasojeni këtë me qasjet e NATO-s dhe BE-së.

-Z. Ambasador, si do t’i komentoni shqetësimet e ekspertëve dhe politikanëve lidhur me ndikimin e mundshëm të konfliktit ruso-ukrainas në sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe botë? Duhet thënë se marrëdhëniet e ngushta mes Rusisë dhe Serbisë shihen si minim dhe pengesë për paqen mes Serbisë dhe Kosovës?

Kërcënimi i ndikimit të krizës ukrainase në sigurinë globale nuk është potencial, por mjaft real. Rusia ka vërejtur në mënyrë të përsëritur se mbështetja nga Perëndimi i regjimit të Kievit, furnizimet e tij me sisteme moderne të armëve, pjesëmarrja e instruktorëve të NATO-s në trajnimin e personelit ushtarak ukrainas vetëm rrisin gjasat e një përplasjeje të drejtpërdrejtë midis Rusisë dhe NATO-s, duke përfshirë zgjerimin e konfliktit të armatosur në vendet e tjera evropiane. Përveç kësaj, fakte të shumta të korrupsionit midis udhëheqjes ushtarake dhe politike të Ukrainës, gjë që njihet edhe nga Perëndimi, ashtu si edhe përfshirja e saj në tregtinë e armëve të furnizuara nga vendet e NATO-s si “ndihmë” ushtarake përbëjnë një kërcënim të rënies së armëve në duart e grupeve terroriste dhe ekstremiste në Lindjen e Mesme, Azi, Afrikë, si dhe vetë Evropën. Qytetarët e zakonshëm të BE-së gjithashtu vuajnë nga politika koniunkte e Bashkimit Evropian dhe sanksionet e paligjshme antiruse. Sipas vlerësimeve të

Eurostat, që nga vendosja e sanksioneve kundër Rusisë vendet evropiane kanë paguar tepër më shumë se 200 miliardë euro për “karburantin blu”. Si rezultat, sektori industrial, veçanërisht industrinë me energji intensive, u gjend në një situatë të vështirë. Sipas të njëjtës agjencie evropiane të statistikave, në janar 2024, vëllimi i prodhimit industrial në BE u ul me 2.1% krahasuar me muajin e kaluar, dhe me 5.7% krahasuar me janarin 2023. Siç parashikon FMN, në vitin 2024 PBB-ja e BE-së do të rritet me jo më shumë se 1.1%. Pavarësisht degradimit të ekonomisë evropiane, rënies së të ardhurave të popullsisë dhe rrjedhjes së kapitalit në rajone më të begata të botës, Komisioni Evropian vazhdon me kokëfortësi të ridrejtojë burimet financiare jo për të mbështetur prodhuesit, sipërmarrësit dhe biznesmenët e tij, por për qëllimet terroriste të regjimit të Kievit.

Tani, sa u përket çështjeve të sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Shpesh dëgjojmë se si “ekspertët” dhe “vëzhguesit politikë” akuzojnë pa arsye Rusinë se kërkon, gjoja, të hapë një “front të dytë” në Ballkan, të destabilizojë situatën këtu për të larguar vëmendjen e vendeve të NATO-s nga konflikti ukrainas. Kjo nuk është e vërtetë. Rusia gjithmonë ka dalë në favor të ruajtjes së paqes në rajon. Mungesa e përparimit në normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës kushtëzohet jo nga roli destruktiv i Kremlinit, por nga veçoritë historike dhe etno-fetare të çështjes së Kosovës, si dhe nga politika e SHBA-së dhe BE-së, të cilat për shumë vite janë përpjekur të monopolizojnë zgjidhjen, për ta çuar atë përtej bazës së vetme legjitime – rezolutës 1244 të Këshillit të Sig-



urimit të OKB-së, duke e detyruar Serbinë të njohë pavarësinë e Kosovës dhe t'i ndërpresë lidhjet vëllazërore historike midis popujve rusë dhe serbë. Fatkeqësisht, udhëheqësit evropianë harrojnë se zgjidhjet e imponuara, pa marrë parasysh interesat themelore të popujve që jetojnë në rajon, janë jetëshkurtra.

-Z.Ambasador, lufta në Ukrainë ka hyrë në vitin e tretë. Si i vlerësoni aktualisht perspektivat e përfundimit të konfliktit dhe cilat janë qëllimet e Rusisë? Pse dështuan bisedimet dhe negociatat diplomatike para nisjes së luftës dhe, gjithashtu, pse ato dështojnë edhe tani për të gjetur një zgjidhje përfundimtare të këtij konflikti?

–Qëllimet e Rusisë gjatë operacionit special ushtarak në Ukrainë mbeten të pandryshuara. Folëm për to jo një herë: këto janë mbrojtja e popullsisë ruse dhe rusishtfolëse në Donbas, çmilitarizimi dhe denazifikimi i Ukrainës dhe eliminimi i kërcënimeve që burojnë nga territori i saj ndaj sigurisë së Rusisë.

Rusia ka propozuar në mënyrë të përsëritur, dhe kjo është e njohur për të gjithë, për të kërkuar një zgjidhje të problemeve në Ukrainë me mjete paqësore. Një plan real-

ist për rivendosjen e paqes dhe integritetit territorial të Ukrainës u fiksua në “Kompleksin e masave për përmbushjen e Marrëveshjeve të Minskut” të nënshkruar në shkurt 2015, asnjë nga pikat e të cilit, meqë ra fjala, nuk u përmbush nga pala ukrainase. Në fund të vitit 2021 Kievi ka deklaruar haptazi për refuzimin nga marrëveshjet e Minskut dhe ka filluar të zbatojë një skenar të “kthimit” të Donbasit në Ukrainë me forcë. Diplomacia ruse nuk u step. Në dhjetor 2021, NATO-ja dhe SHBA-ja u ftuan të nënshkruanin me Rusinë dy marrëveshje për garancitë ligjore të sigurisë që do të hapnin rrugën për paqe të qëndrueshme në kontinentin tonë. Sidoqoftë, siç e dini, propozimet e Moskës u refuzuan.

Përpjekjet për të rivendosur paqen në Ukrainë u bënë në Stamboll në mars 2022 dhe arritën një fazë mjaft e lartë dakordësimi të qëndrimeve. Marrëveshjet e Stambollit madje u nënshkruan paraprakisht nga pala ukrainase. Sidoqoftë, siç pranoi kreu aktual i fraksionit të partisë në pushtet “Shërbëtori i popullit” në parlament, David Arhamia, në fund të nëntorit 2023, pas bisedimeve ruso-ukrainase në Stamboll, kryeministri britanik i atëhershëm, Boris Johnson mbërriti me nxitim në Kiev dhe i bëri thirrje Zelenskyt të mos nënshkruante asgjë me Rusinë dhe “vetëm të luftonte”. Për më tepër, në tetor 2022 Presidenti i Ukrainës ka nënshkruar një dekret që e ndaloi atë të zhvillojë ndonjë negociatë me Rusinë. Ky dekret është ende në fuqi. Reagimi ashpër negativ i autoriteteve ukrainase ndaj iniciativave paqeruajtëse të vendeve të Jugut global është gjithashtu tregues. Pra, në një intervistë të fundit për mediat indiane, Zelensky përsëriti mungesën e al-

ternativave ndaj “formulës së tij të paqes”, arriti deri aty, sa shantazhoi hapur Nju Delhin, duke kërkuar braktisjen e pozicionit neutral mbi konfliktin ukrainas. Me pak fjalë, është regjimi i Kievit dhe sponsorët e tij perëndimorë që nuk kanë interes për një zgjidhje politike dhe diplomatike të krizës. Ndryshe nga Ukraina, Rusia është e hapur për negociata dhe çdo propozim serioz që vërtet synojnë arritjen e paqes. Sidoqoftë, këto duhet të jenë negociata, dhe jo ultimatumet si “Formula e Zelensky-t” ose iniciativa të tjera të ngjashme.

-Këtë vit Shqipëria feston 80-vjetorin e çlirimit nga pushtimi nazifashist në Luftën e Dytë Botërore, në të cilën Rusia, si pasardhëse e BRSS, ishte ndër fituesit. Si e komentoni Ju këtë ngjarje historike dhe kontributin e shqiptarëve në atë luftë?

–Në të vërtetë, më 29 nëntor të këtij viti, Shqipëria do të festojë 80-vjetorin e çlirimit të vendit nga nazistët dhe fashistët. Populli shqiptar është krenar – dhe ne e ndajmë këtë krenari – që arriti çlirimin e vendit nga nazistët me forcat e veta. Në luftën për lirinë e saj ranë 28 mijë patriotë trima të Shqipërisë. Ne e dimë dhe nuk harrojmë këtë.

Në të njëjtën kohë, kjo fitore u bë e mundur për shkak të humbjes së trupave fashiste në frontin sovjetiko-gjerman. Pikërisht ky kuptim i ngjarjeve mbeti i pandryshuar në Shqipëri nga ato vitet e largëta 1940 deri kohën e fundit. Për shembull, në Deklaratën e Beratit të mbledhjes së 2-të të Këshillit antifashist nacionalçlirimtar të Shqipërisë (tetor 1944) thuhej si më poshtë: “Ne e konsiderojmë Ushtrinë e Kuqe forcën kryesore që mundi armikun e betuar të

njerëzimit. Për më tepër, për ne ajo është një simbol i luftës antifashiste për liri, garancia më e madhe e të drejtave tona. Ne i jemi mirënjohës Bashkimit Sovjetik për këtë, dhe populli ynë nuk do ta harrojë kurrë ndihmën e madhe dhe luftën heroike të Ushtrisë së Kuqe, e cila na shpëtoi nga katastrofa”.

BRSS dhe Shqipëria ishin në të njëjtën anë të frontit, si pjesë e koalicionit anti-hitlerian, së bashku po afronin fitoren mbi fashizmin në Evropë. Kjo është fitorja jone e përbashkët mbi armikun e fortë dhe të pamëshirshëm, që shërbeu si një themel i sigurt për bashkëpunim të ngushtë dhe ndërveprim midis dy vendeve në vitet e pasluftës. Bëma e veteranëve që afruan fitoren mbi fashizmin në front dhe në prapavijë nuk do të harrohet kurrë.

-Duke iu rikthyer marrëdhënieve bilaterale, cili është vizioni juaj për të ardhmen e marrëdhënieve ruso-shqiptare? Si mund të zgjerohet bashkëpunimi ekonomik ndërmjet dy vendeve, dhe cilat janë sektorët me potencial më të madh për zhvillim?

– Jam i bindur që gjithmonë duhet ta shikojmë në të ardhmen me optimizëm. Ka çdo arsye për këtë. Popujt tanë janë të bashkuar me respektin për kujtesën e paraardhësve të tyre, për historinë e tyre, me bashkëjetesën paqësore të ortodoksëve, katolikëve, myslimanëve, përfaqësuesve të konfesionëve të tjera, me dashurinë për vendin e tyre dhe shumë më tepër. Popullsia e Shqipërisë, veçanërisht brezi i vjetër, ende ruan një interes për kulturën ruse dhe gjuhën ruse. Është kënaqësi të vëresh se si në Teatrin Kombëtar të Operës dhe

Baletit në Tiranë dhe në ambiente të tjera mbahen koncerte muzikore me sallën plot, gjatë të cilave muzikantët interpretojnë vepra të P.I.Çajkovskit, N.A.Rimsky-Korsakov dhe kompozitorëve të tjerë të famshëm rusë. Në fund të dhjetorit, në prag të Vitit të Ri, në skenën kryesore të Shqipërisë trupat lokale do të interpretojnë baletin “Arrëthyesi” bazuar në motivet e klasikëve rusë. Publiku në Rusi gjithashtu tregon interes për artin dhe, në veçanti, letërsinë shqiptare. Kështu, në rusisht janë përkthyer romanet e I.Kadaresë “Dimri i Madh”, “Pallati i Ëndrrave”, “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur”, prezantimi i botimit të ri të të cilit u zhvillua në Moskë në tetor të këtij viti.

Rusia ka çfarë t’i ofrojë Shqipërisë edhe në sferën ekonomike. Vendi ynë ka zhvilluar kompetenca të mira në fushën e teknologjisë së lartë, digjitalizimit, industrisë prodhuese, mjekësisë dhe IT-së. Kemi teknologji të përparuara në fushën e energjisë bërthamore paqësore, zhvillojmë në mënyrë aktive burime alternative të energjisë bazuar në zgjidhjet inxhinierike ruse dhe vazhdojmë të mbetemi një furnizues i besueshëm i burimeve të naftës dhe gazit. Një tipar dallues i Moskës është se, duke ofruar bashkëpunim për vendet e huaja, ne nuk kërkojmë ndërprerjen e ndërveprimit me vendet e tjera. Do të jemi të gatshëm të shqyrtojmë mundësinë e rifillimit të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik me Shqipërinë sa më shpejt që të lejojnë realitetet politike.

M.Doda: Z.Ambasador, fale-minderit për këtë intervistë!

Ambasadori: Faleminderit. Besoj se biseda jonë e sotme do të jetë e dobishme dhe do të gjejë interes mes publiku shqiptar.

A ka Evropa zgjidhje për dialogun Kosovë-Serbi?

Kaja Kallas, si shefe e re e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, ka mundësinë të riformojë qasjen e bllokut ndaj dialogut Kosovë-Serbi. Megjithatë, gjatë seancës së saj të konfirmimit, ajo praktikisht nuk e përmendi këtë çështje, duke ngritur pikëpyetje në lidhje me angazhimin e ardhshëm të BE-së në ndërmjetësimin e paqes mes dy vendeve.

Dialogu është një nga kushte kryesore për përparimin e të dyja shteteve drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Pjesëmarrësit në dialog janë të angazhuar për të adresuar çështje si kufijtë, të drejtat e pakicave, liria e lëvizjes dhe implementimi i marrëveshjeve të arritura.

Megjithatë, gjatë dëgjimit të saj, Kallas nuk u ndal shumë tek dialogu, duke u shprehur se Ballkani Perëndimor është një rajon shumë i rëndësishëm dhe se BE-ja i qaset atij përmes dy rrugëve: zgjerimit dhe procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Kandidatja për postin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Kaja Kallas, tha të martën në një seancë dëgjimore se do të angazhohet për forcimin e sigurisë së bllokut evropian dhe do të bashkëpunojë me fqinjët që ndajnë vlerat. të përbashkëta, si dhe kanë aspirata për anëtarësim në bllokun evropian.

Dy prioritete urgjente për Bashkimin Evropian

Sipas Kallas, ka dy “prioritete urgjente” për BE-në – të



ndihmojë Ukrainën që të fitojë luftën kundër Rusisë, duke siguruar mjete të mjaftueshme dhe të gjejë zgjidhjen për situatën e vështirë në Lindjen e Mesme.

“BE, mbi të gjitha, për mua do të thotë liri. E kaluara e Estonisë na ka mësuar vlerën e lirisë. Jam rritur pas perdes së hekurt, pa asnjë liri. Që kur rifitua pavarësinë, kam pasur mundësinë të jetoj një jetë plot mundësi, demokraci dhe liri. Nëse do të fitoj besimin tuaj për të marrë këtë rol, do të bëj çmos për të shërbyer në interes të Evropës dhe për të forcuar pozitën e Evropës në botë”, tha ajo.

“Ne duhet të kuptojmë se cili është kërcënimi dhe të korrespondojmë në përputhje me rrethanat, së bashku me miqtë dhe aleatët tanë, dhe pa humbur asnjë centimetër të asaj që jemi... BE-ja ka qaq shumë për të ofruar, ajo është një kampione

e paqes dhe prosperitetit... Ne duhet të bëjmë më mirë dhe dëgjo më mirë”, theksoi Kaja Kallas. Duke folur për nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme për Ukrainën, Kallas vuri në dukje se ajo “duhet të mbështetet nga rruga e qartë e BE-së për vendin”. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se BE-ja duhet të investojë më shumë në siguri, sepse “aktorë si Rusia, Kina, Koreja e Veriut dhe Irani synojnë të ndryshojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla”.

“Ne nuk mund të pranojmë që Kina, Rusia, Koreja e Veriut dhe Irani po prodhojnë më shumë municion sesa BE-ja”, pohoi ajo.

Vetëm një pyetje për Ballkanin

Në fund të seancës ajo u pyet për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, çështje me të cilën do të merret gjatë mandatit të saj si kryediplomate e BE-së.



KAJA KALLAS

Ballkani Perëndimor është një rajon shumë i rëndësishëm dhe shumë afër kufijve tanë. Ne kemi dy rrugë që po punojmë atje, e para është zgjerimi ku duhet të punojmë me Komisionerin për Zgjerimin. Siç e thashë edhe më herët, ne vërtet duhet të kemi një histori suksesi në pesë vitet e ardhshme, sepse kjo nuk është vetëm për prosperitetin e rajonit, por edhe për t'i dhënë shpresë rajonit Prodhimi i Brendshëm Bruto, 35 për qind e mesatares së BE-së, ndërsa tani është mbi 90 për qind, pra jep rezultate si makinë konvergjence.

Ajo nuk e përmendi dialogun as në fjalën e hapjes dhe as në fjalën mbyllëse dhe nuk pati pyetje nga deputetët e Parlamentit Evropian. Vetëm në fund të debatit pyetja e fundit ishte ajo e deputetes nga Kroacia, Zhejlana Zovko, e cila pyeti për bashkëpunimin me SHBA-në për ruajtjen e paqes në Bosnje-Hercegovinë dhe në fqinjësinë juglindore të BE-së. Më pas, Kallas ka përmendur edhe dialogun.

“Ballkani Perëndimor është një rajon shumë i rëndësishëm dhe shumë afër kufijve tanë. Ne kemi dy rrugë që po punojmë atje, e para është zgjerimi ku duhet të punojmë me Komisionerin për Zgjerimin. Siç e thashë edhe më herët, ne vërtet duhet të kemi një histori suksesi në pesë vitet e ardhshme, sepse kjo nuk është vetëm për prosperitetin e rajonit, por edhe për t'i dhënë shpresë rajonit Prodhimi i Brendshëm Bruto, 35 për qind e mesatares së BE-së, ndërsa tani është mbi 90 për qind, pra jep rezultate si makinë konvergjence”, tha ajo.

“Rruga e dytë është dialogu Kosovë-Serbi, ku të gjithë paraardhësit e mi kanë investuar shumë kohë për të sjellë stabilitet në rajon”, shtoi ajo.

Kallas ka paralajmëruar se në pjesën e parë të mandatit të saj do të shkojë në rajon dhe do të bisedojë me ato vende për të parë se çfarë mund të bëhet.

Ajo tha se zgjerimi nuk duhet parë si një lojë ku humbet ose fiton, ku të gjithë duhet të jenë brenda ose jashtë, por duhet punuar me parimin e meritës individuale për të parë se çfarë mund të bëhet.

Kryesisht pyetje rreth Ukrainës Sipas saj, sfidat kryesore për BE-në dhe aleatët lidhen me afrimin

e Rosisë, Kinës, Iranit dhe Koresë së Veriut, vende të cilat sipas saj po sfidojnë rendin botëror.

Ajo e ka konsideruar si prioritet vazhdimin e ndihmës për Ukrainën dhe fitorja e Kievit është konsideruar e nevojshme për Evropën.

Kallas ka thënë se nuk ka kthim prapa në rrugën e Ukrainës drejt BE-së dhe se blloku duhet të vazhdojë të ndihmojë Ukrainën aq sa është e nevojshme.

Sipas saj, “Rusia nuk ka humbur ende asnjë luftë kolonizimi dhe ka ardhur koha që ajo ta humbasë këtë në Ukrainë dhe vetëm pasi Rusia të humbasë, do të çlirohet dhe do të ecë përpara”.

Kallas tha se “nëse agresioni jep frytet në një vend, atëherë kjo është një ftesë për agresion në një vend tjetër, prandaj agresioni i Rosisë në Ukrainë duhet të dështojë”.

Shumë deputetë, kryesisht të ekstremit të majtë dhe të djathtë e kanë qortuar kandidaten Kallas se ajo “mbështet luftën që po dëmton Europën”.

Mirëpo, ajo u përgjigj se në asnjë rast nuk e përkrah luftën, është për paqe, por duhet ditur se Rusia

është ajo që e ka nxitur luftën.

“Ukrainasit po vdesin çdo ditë, ata duan paqen më shumë se kushdo tjetër. Por paqja nuk mund të arrihet duke lejuar agresorin të marrë atë që do”, tha Kallas.

Ndër të tjera, Kallas hodhi poshtë pohimet se BE ka pasoja për mosfurnizimin me gaz nga Rusia. Sipas saj, që nga fillimi i agresionit të Rosisë në Ukrainë, BE-ja ka rritur ndjeshëm pavarësinë e saj nga Rusia, kur bëhet fjalë për furnizimin me naftë dhe gaz.

Kallas ka kërkuar që sanksionet ndaj Rosisë të zbatohen më rreptësisht dhe të merren masa ndaj atyre që ndihmojnë në anashkalimin e tyre.

Seanca dëgjimore për 26 anëtarë të Komisionit Evropian do të përfundojë të martën.

Shefi i BE-së Von der Leyen tashmë është konfirmuar.

Nëse të gjithë kandidatët marrin mbështetjen e komisioneve parlamentare, atëherë më 24 ose 25 nëntor Parlamenti Evropian duhet të konfirmojë Komisionin e ri Evropian.

Në atë rast, Komisioni do të fillojë mandatin e tij më 1 dhjetor të këtij viti.

Pse nuk kemi pasur lider të mëdhenj deri tani?

Nga Alban Daci

Tashmë kanë kaluar 34 vite tranzicion dhe është momenti që duhet t'i analizojmë këto tre dekada, ndërsa jemi thujse edhe në gjysmën e dekadës së katërt.

Dikush mund ta quajë të shkurtër këtë periudhë. Në fakt nuk është tamam ashtu. Ne shpesh akoma merremi me Regjimi kohëzgjatja e të cilit nuk është më shumë se 40 vjet. Vazhdojmë të merremi me 40 vite e një Regjimi dhe po harrojmë se po bëjmë tashmë 40 vite të tjera në një regjim tjetër të quajtur "tranzicion". Në fakt, gjatë këtyre dekadave që po jetojmë, duke mos ditur që të vendosim një emërtim të saktë i kemi rënë shkurt me terminologjinë "tranzicion". Me përdorimin e këtij emërtimi po justifikojmë katër dekada që janë shumë.

Nuk duhet të harrojmë se koha është çmuar për individët po aq sa është e çmuar edhe për një vend. Në gjithë botën për tre dekada kanë ndodhur shumë gjëra intensive, si pozitive edhe negative, por kanë ndodhur. Ndërsa, tek duket sikur asgjë nuk ka ndryshuar e po ashtu edhe qasja jonë me emërtimin nuk ka ndryshuar, sepse e filluam në vitet '90 me termin tranzicion dhe po ashtu edhe sot mbetet i vetmi term që justifikojmë kohën.

Kjo do të thotë se nuk ka ndodhur asgjë, nuk ka lëvizur asgjë dhe për pasojë status quo-ja ka mbetur e njëjtë. Në fakt kohë identifikohet me lider që janë njerëz dhe kur ata mbeten të njëjtët edhe ndryshimet nuk ndodhin.

Pra, për sa kohë kemi të njëjtin lider do të thotë se s'kemi risi e kur nuk ka risi do të thotë se nuk ka pasur ndryshime ose iniciativa për të bërë ndryshimin. Po pse nuk kemi pasur ndryshime? Sepse, ne nuk kemi pasur lider të mëdhenj? Po

kush janë liderit e mëdhenj? Janë ata që guximin për të bërë aksione për ndryshime të mëdha edhe për një hark të gjatë kohor.

Ne, nuk kemi pasur kështu liderësh, sepse edhe pse të pakt në numër kanë menduar vetëm për aksione apo ndryshime sporadike me efekte të menjëhershme, pa pasur guximin apo vullnetin për reforma të thella strukturore dhe sistemike.

Këta nuk janë lider të mëdhenj, sepse i kanë rënë shkurt e duke u sjellë kështu nuk kanë qenë në shërbim të vendit, por vetëm të optikës të marrjes ose mbajtjes të pushteti. Shumica e atyre që kanë qenë lider e vazhdojnë të jenë në Shqipëri nuk kanë



menduar për të shkruar historinë, por thjeshtë kanë preferuar të jenë në librin e vizitorëve të historisë.

Objektivat e vetëm e kryesorë të liderëve tanë kur janë në Opozitë është të mendojnë të marrin sa më shpejt pushtetin e kur janë në Pozitë mendojnë të mos ndërmarrin vendime apo reforma të thella, por kanë menduar vetëm për aksionet ose vendimet që pushtetin ta mbajnë. Nga ky deduksion është fare e thjeshtë të kuptojmë se pushteti i liderëve tanë nuk ka qenë e nuk është si një instrument serioz përfaqësimi për t'i shërbyer vendit, por vetëm një mekanizëm për të ruajtur status quo-n dhe për ta përdorur pushtetin si qëllim më të rëndësishëm për privilegje në shërbim personal dhe të personave që i rrethojnë.

Vendet e tjera e sidomos demokracitë në këto thujse katër dekada kanë pasur lider që kanë shkruar historinë e kanë mbetur në histori për vendi-

met e tyre apo edhe për qëndrimet e tyre. Po në Shqipëri a kemi lider të tillë? Në Shqipëri kemi pasur e kemi lider që e kanë konsumuar me pushtet kohën dhe këtë të fundit nuk e kanë konsideruar si një hapësirë për të bërë gjëra të mëdha që historia do i merrte në konsideratë.

Ndoshta pyetja më e sinqertë për liderët shqiptarë do të ishte: I kanë shërbyer kohës, apo e kanë mbajtur peng këtë fundit duke penguar çdo gjë të re që mund të ndodhte e duhet të ndodhte! Duke qenë se e kanë të pamundur të largohen edhe kur vetë koha duket se i ka braktisur, atëherë arrijmë në konkluzionin se ata e kanë marr peng kohën e bashkë me të edhe të ardhmen tonë.

Pse e kanë marr peng të ardhmen tonë? Duke mos pasur asgjë të re as në terminologji për të identifikuar periudhën pas rënies të Regjimit e deri në ditët e sotme do të thotë, se ne jetojmë të tashmë në çdo moment, e

mbajmë thujse fiks vështrimin nga e kaluara dhe nuk mendojmë aspak për të ardhmen. Duket sikur për shkak të politikës ose të politikanëve sikur jemi të ndëshkuar dhe të privuar për të pasur të ardhme. Aq shumë është i lidhur lidhshipi shqiptar me të kaluarën sa edhe dialektika e tyre është: Ti ke bërë këtë? Ti e bërë atë? Ti ke qenë kështu? Asnjëri prej tyre thujse nuk e përdor fare lakimin e foljes në kohën e ardhme me "do të...". Nuk flasin për të ardhmen, sepse nuk kanë vizione për të dhe po ashtu nuk janë shumë të interesuar për të! Kjo situatë na ka bërë që të jetojmë në një hapësirë absurde kohore mes të tashmes e të kaluarës duke e fshirë de facto të ardhmen. Prandaj, në këto thujse katër dekada nuk kemi pasur lider të mëdhenj, por lider që kanë tentuar ta mbajnë peng kohën duke u identifikuar me të kaluarën dhe me konsumimin e të tashmes.

Trumpi tronditi politikën botërore! BE e re me sfida të vjetra! Komunitet ambulant! Xhirobosh!

REAL POLITIK FLASH NR. 99 |

1 – 15 NENTOR 2024 |

EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1. Trumpi tronditi politikën botërore me fitoren e tij të paparashikuar, të bujshme dhe shumëdimensionale! Nxorri “jashtë lojë” median, sondazhet, analistët dhe yjet e hollivudit! Me diferencë të madhe votash popullore, me 312 vota të sigurt në Kolegjin Zgjedhor nga 270 të nevojshme; pushtoi Senatin, Dhomën e Përfaqësuesve dhe të 7 shtetet e lëkundura! Ky është komponenti i parë madhor që tregon pse dhe si Trump tronditi politikën amerikane dhe atë planetare. Një fitore që “nxorri zbuluar” Presidentin dhe Zv.presidenten Biden/Harris dhe demokratët. Këta të fundit, në vend të qetësohen dhe të bëjnë analizat e rastit me gjakftohtësi dhe realizëm, po e kërkojnë fajin te të tjerët, deri te Holivudi dhe Taylor Swift! Sigurisht tronditja më e madhe politike trumpiane vjen se ajo do të sjellë një paradigme të re politike dhe diplomatike mbasi Trump të hyjë në Shtëpinë e Bardhë. Shtetet dhe organizatat e mëdha ndërkombëtare kanë filluar llogaritjet dhe mbi atë bazë hartimin dhe miratimin e strategjive përkatëse politike,



diplomatike, ekonomike dhe ushtarake: BE-ja dhe NATO me Shtetet Anëtare, Kina, Rusia, BRICS, OKB-ja dhe filialet e saj që siç dihet nuk është se Trump i ka shumë për zemër. Ka plot pasiguri, paqartësi dhe frikë. Gjithsesi, për të shmangur abuzimet e rastit, duhet pritur ende deri në janar të paktën, sa të krijohet gjithë ekipi dhe të jenë paraqitur dokumentat përkatëse strategjike të qeverisë së Presidentit Trump. Ndaj, pa ngut dhe nxitim!

2. Komunitet ambulant ose lëvizës, kështu është katandisur Komuniteti Politik Europian(KPE) i lançuar me bujë të madhe mbi 2 vjet më parë nga Presidenti francez Macron. Nga premtimet e bujshme, vetëm 5 samite, më i fundit në Budapest më 7 nëntor dhe tjetri në Tiranë vitin e ardhshëm. Pa seli, pa adresë, pa struktura drejtuese, pa taban, pa program dhe mis-

ion, pa asnjë vendim, pa një komunikatë shtypi dhe plot ” Pa” të tjera. Dhe po qe se do të vijojë kështu, siç ”duken dhe bathët”, atëherë do të vërtetohen parashikimet e analistëve që KPE-ja të kthehet në një organizatë qeveritare në nivel ministrash. Ose do të jetë shumë më tepër një komunitet ambulant ose lëvizës, me një tur ” eskursionesh tematike dhe turistike” europiane, kryesisht me ” talk and eating” apo forum diplomatik i nivelit më të lartë por me ndikimin, jehonën më të ulët politike, diplomatike dhe publike.

3. BE e re me sfida të vjetra! Nga 4 – 12 Nëntor, në selinë e Parlamentit European në Strasburg u zhvilluan seancat dëgjimore, ku 26 komisionerët e lartë të BE-së të emëruar nga Presidentja e Komisionit, Ursula von der Leyen paraqiten programet e tyre dhe iu përgjigjen qindra pyetjeve të Eurodeputetëve.

Gjithçka shkoi mirë, dmth pa ndonjë kthim ose prapsim. Kështuqë më 1 Dhjetor, më në fund, Komisioni European do të nisë mandatin e tij të ri 5 vjeçar, me shumicën fytyra të reja por dhe disa të vjetra, duke përfshirë Presidenten e tij bashkë me Europarlamentin dhe Këshillin e ri European. Ndaj flitet për një Europë me drejtues të rinj, me programe dhe premtime të reja. Por gjithsesi bien në sy, madje ulërasin për zgjidhje idetë, sfidat dhe problemet e trashëguara nga e kaluara e afërt dhe të porealizuara nga ekipet e mëparshme të BE-së. Veçse tani ”zullumet” janë trashur dhe më shumë; ca më keq akoma, sepse në krye të Shtëpië së Bardhë nuk do të jetë më një Euro-Atlantist i bindur si Presidenti Biden. Ndërkohë, lufta e Ruisë kundër Ukrainës po hyn në vitin e saj të katërt me shumë të panjohura dhe rreziqe, ndërsa kriza në Lindjen e Mesme vazhdon të përkeqësohet dhe përshkallëzohet pa asnjë të ardhme paqeje. As Balkani 12 vite mbas fillimit të dialogut Serbi – Kosovë të lehtësuar nga BE-ja nuk po gjen qetësi, mes rreziqesh dhe më të mëdha. Zgjerimi European po mbahet me shpresa dhe premtime euforike dhe larg realiteteve tanimë me objektiv jo zyrtar por indikativ vitin 2030; ndoshta pa e kuptuar se vetëm nevojat gjeopolitike nuk i japin dot drejtim dhe zgjidhje, ca më tepër kur të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë Shqipërinë, megjithë arritjet, sërish ndeshen me problematika të nxehta. Ndërkohë, Franca mezi po ”mbahet në këmbë me paterica”, ndërsa Gjermania do



të shkojë në kutitë e votimit para kohe më 23 Shkurt 2025, me pasiguri për koalicionin e ri qeveritar që do të dojë ndoshta muaj të tërë. Kur ekstremi i djathtë synon të zgjerojë gjeografinë politike mbas Italisë, Holandës, Austrisë dhe Suedisë dhe në Francë, Gjermani, Spanjë dhe gjetkë.

4. Xhiroboshe janë në fakt ecejaket drejt Brukselit të kryenegociatorëve të dialogut Prishtinë – Beograd. Plot deklarime, pohime dhe premtime, por tamam si xhiro bosh. E kemi përmendur dhe më parë se ai dialog është vërtet « i vdekur por i pakallur ». Ndaj lëvizjet e tanishme janë sa për të kaluar kohën, për të justifikuar pagën e lartë të Laçakut dhe për të mbajtur status kuonë e rastit. Asgjë më shumë deri sa të sistemohen në zyrat e tyre drejtuesit dhe ndërmjetësuesit e rinj në Uashington dhe në Bruksel, të zhvillohen zgjedhjet e reja parlamentare në Kosovë më 9 shkurt dhe në Gjermani më 23 shkurt. Dhe sa të përcaktohet strategjia e re e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit. Çka praktikisht i bie të jetë gati nga mesi i vitit 2025,

edhe pse vështirë të ketë ndonjë ndryshim thelbësor dhe ca më pak ndonjë « breakthrough ». Ndaj deri atëhere politika në Kosovë dhe udhëheqësia e saj duhet të reflektojnë, të përpunojnë versione dhe alternativa të ndryshme se si të dalin sa më shpejt dhe « pa u lagur » nga ngërçi i tanishëm. Çdo hap i hedhur me kujdes dhe në bashkërendim me aleatët tanë perendimorë do ta ndihmojë Prishtinën zyrtare në heqjen e masave ndëshkuese nga BE-ja, shtimin e njohjeve dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare që kanë mbetur në vend numëro! Vetëm kështu Kosova mund të bëhet shtet vërtet funksional, në begati, siguri, dhe demokraci të qendrueshme. Boll me moralizime dhe parime jashtë realiteteve të politikës dhe diplomacisë botërore, ca më tepër kur ndryshe nga 15 vite më parë, Kosova nuk është më në krye të axhendës ndërkombëtare. Sot kjo axhendë është plot e përplot dhe me disa pika të nxehta që kanë përparësi. Ndaj, politika në Prishtinë duhet të tentojë të bëhet pjesë e zgjidhjes dhe jo pjesë e problemit, që ta tregojnë me gisht, qoftë dhe kur nuk ka faj.

FJALIMI I FUNDVITIT NË KUVEND

Presidentja Osmani: Rrezikimi i partneritetit me aleatët cenon vetë mbrojtjen e Kosovës

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin vjetor para deputetëve bëri thirrje për ruajtjen e marrëdhënieve me vendet aleate, duke thënë se cenimi i raporteve me këto vende e cenon vetë Kosovën. Ajo e cilësoi si të pabalancuar dialogun me Serbinë dhe kërkoi trysni ndërkombëtare ndaj Serbisë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve atje.

Duke folur të enjten në një seancë parlamentare të bojkotuar nga dy prej tri subjekteve më të mëdha opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, presidentja e vendit tha se “aleanca e Kosovës me vendet e tjera është më e madhe dhe më e rëndësishme se cilido prej nesh si politikan”.

“Të punosh me ata që na kanë ndihmuar ta kemi lirinë e shtetit, asnjëherë nuk është nënshtrim e as shantazhim. Besoj fuqishëm se forca jonë më e madhe qëndron pikërisht në aleancat tona”, tha Osmani në Kuvendin e Kosovës.

Ajo bëri thirrje që Kosova t'i ruajë aleancat e saj, sepse ato, sipas saj, janë “gur themeltar i sukseseve tona dhe investim në të ardhmen tonë, ku Kosova do të jetë anëtare e barabartë në komitetin euroatlantik të kombeve të lira”.



“Aleancat janë këtu për të na mbrojtur, prandaj vënia në rrezik e tyre, luajtja bixhoz me to, apo cenimi i tyre, e cenon vetë mbrojtjen e republikës sonë”, tha ajo.

Ajo i bëri thirrje spektrit politik të këtë angazhim të madh vitin e ardhshëm për anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare.

Në fjalimin e saj, Presidentja Vjosa Osmani theksoi angazhimin e saj gjatë vitit 2024 për forcimin e shtetësisë së Kosovës dhe përfaqësimin e saj në arenën ndërkombëtare. Ajo foli për thellimin e aleancave dhe partneriteteve me shtete të ndryshme, duke e pozicionuar Kosovën si një forcë proaktive për paqe dhe zhvillim, veçanërisht në rajonin e Ballkanit dhe

më gjerë.

Osmani nënvizoi se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në skenën globale, duke forcuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe partnerët në Evropë, si dhe duke u angazhuar aktivisht në samite ndërkombëtare, përfshirë ato të NATO-s. Ajo tha se angazhimi i Kosovës në politikën e jashtme është shtrirë në kontinente të tjera, duke përfshirë Afrikën, Azinë dhe Amerikën Latine, dhe ka kontribuar në një rritje të dukshmërisë së Kosovës në botë.

Në lidhje me sfidat e ardhshme, Presidentja Osmani vuri theksin te rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, avancimi i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe fillimi i procesit për anëtarë-

sim në NATO. Ajo shprehu besimin se, megjithë sfidat, Kosova do të vazhdojë me këmbëngulje dhe përkushtim në rrugën e saj për të arritur këto qëllime.

Osmani gjithashtu adresoi shqetësimet për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në rajon, përfshirë Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, duke theksuar se do të bëjnë gjithçka për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve dhe për të siguruar avancimin e tyre në çdo vend ku jetojnë. Ajo theksoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm me Shqipërinë për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe për ecurinë përpara drejt integrimit euroatlantik.

Në këtë fjalim, udhëheqësjja e Kosovës, si Komandante Supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), thekson rëndësinë e forcimit të ushtrisë për sigurimin e një shteti të fuqishëm dhe të pavarur. Ajo i jep një vend të rëndësishëm zhvillimit të FSK-së, duke e lidhur me sigurinë kombëtare dhe forcimin e kapaciteteve të vendit. Ajo nënvizon gjithashtu përpjekjet për të bashkëpunuar ngushtë me aleatët ndërkombëtarë, sidomos me SHBA-të, për anëtarësimin

